



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 22.04.2013

Nr. 92-544

PËR: Pal Leka, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Xhavit Alijaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Gjakovës

LËNDA: KONFIRMIM I LIGJSHMËRISË SË DRAFT-MARRËVESHJES PËR
BASHKËPUNIM KOMUNAL NDËRKOMBËTAR TË KOMUNËS SË
GJAKOVËS, 01 Nr. 020-2255, Pranuar me datë, 18.04.2013.

Të nderuar

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, në përputhje me mandatin e saj të përcaktuar me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale Nr. 03/L-040, Ligjit nr. 04/L-010, Për Bashkëpunim Ndërkomunal, shtojcën XII të Rregullores Qeveritare 02/2011 për Fushat dhe përgjegjësitë administrative të Zyrës së Kryeministrit Ministrive, pas shqyrtimit të Draft-Marrëveshjes 01.nr.020-2255, të miratuar me datë 18.04.2013, **KONFIRMON** ligjshmërinë e këtij akti dhe vlerëson se e njëjta është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale dhe Ligjin për Bashkëpunim Ndërkomunal.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL -së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 22.04.2013
Nr. 92-544

Za: Pal Leka, Gradonačelnik Opštine Djakovica
Xhavit Alijaj, Predsedavajući Skupštine Opštine Djakovica

**PREDMET: POTVRDA ZAKONITOSTI MEMORANDUMA SPORAZUMEVANJA
MEDJUNARODNE OPŠTINSKE SARADNJE OPŠTINE DJAKOVICA,
01br.020-2255, Priljeno dana, 18.04.2013.**

Poštovan-e

Ministarstvo administracije Lokalne samouprave u skladu sa svojim mandatom odredjenim po Zakonu za lokalnu samoupravu, b. 03/L-040, dodatak XII Uredbe Vlade 02/2011 o poljima administrativne odgovornosti kabineta Premijera i Ministarstva, posla razmetranja Sporazuma 01Nr.020-2255, suvojeno dana 18.04.2013, **POTVRDJUJE** zakonitost ovog akta i ceni da je isti u skladu sa Zakonom za lokalnu samoupravu .

S poštovanjem,

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MAIS-a,

Kopje: Besnik Osmani, Sekretar i Përgjithshëm i MAPL -së
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së.



01 Nr. Br. 020-2251
18.04.2013

HYRËSE-ULAZNA-INCOMING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
DEVEJA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVO

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministria e Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Data
Datum
Date
18.04.2013

Tipi i organizatës	Nr i Lëndës	Shifra	Ura
- III -	32-844	1	



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVAOVËS

Data/nr	18.04.2013/ _____
Për:	Z. Besnik Osmani , Sekretar i Përgjithshëm i MAPL-së
CC:	Z. Agron Maxhuni , Drejtor i Departamentit Ligjor në MAPL
Nga:	Dr. Pal Lekaj, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Aktpërcjellës -lidhja:Vlerësimi i Marrëveshjes për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar

Të nderuar!

Bashkangjitur me këtë aktpërcjellës, Ju dërgoj projektin e Marrëveshjes për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar , të themeluar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës Lodeve të Francës, për vlerësimin e ligjshmërisë së këtij dokumenti.

Ju njoftoj se me dt: 10.05.2013, Komunën e Gjakovës do ta vizitojnë zyrtarët e Komunës Lodeve, andaj ju lus që t'i ipet prioritet shqyrtimit të ligjshmërisë së kësaj Marrëveshjeje, në mënyrë që e njëjta të përcillet në Komunën Lodeve për plotësimin e të dhënave të llogos, etj, dhe të përgatitet për nënshkrim në solemnitetit e shpalljes së bashkëpunimit dhe binjakëzimit të komunave : Gjakovë dhe Lodeve .

Me respekt !

Me prioritet për
vlerësimin për shkak të
vizitës së delegacionit



Logoja e
Komunës
Lodëve

Republika e Kosovës – Republika Kosova
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica

Komuna e Gjakovës e Republikës së Kosovës dhe Komuna Lodëve e Republikës së Francës, duke u bazuar në vullnetin e lirë për bashkëpunim komunal ndërkombëtar dhe me qëllim të ofrimit të kushteve më të mira për qeverisje komunale, me dt:...../2013 e lidhin këtë:

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI KOMUNAL NDËRKOMBËTAR

Themelues të Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar janë:

- I. Komuna e Gjakovës , të cilën e përfaqëson Kryetari i kësaj Komune Dr. Pal Lekaj
- II. Komuna Lodëve , të cilën e përfaqëson Kryetarja e kësaj Komune znj. Marie – Christine Bousquet

Neni 1

Lënda e Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Lëndë e kësaj Marrëveshjeje është themelimi i Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës Lodëve, në lëmin e kulturës, arsimit, artit, sportit etj, mbi bazën e vullnetit të lirë të përfaqësuesve të këtyre komunave respektive.

Neni 2

Qëllimi i bashkëpunimit

2.1 Përfaqësuesit e Komunës së Gjakovës dhe të Komunës Lodëve do të angazhohen për themelimin e lidhjeve qytetare, promovimin, avancimin dhe kultivimin e vlerave të kulturës, letërsisë, arsimit, sportit, artit etj, në kuadër të kompetencave për qeverisje komunale.

2.2 Pjesëmarrja e përfaqësuesve të poetëve të dy komunave respektive në Mitingun Tradicional të Poezisë në Gjakovë, si dhe në Manifestimin Ndërkombëtarë të Poezisë në Lodëve.

2.3 Njohja dhe promovimi i veprave letrare të poetëve dhe shkrimtarëve Francez dhe atyre Kosovare, në kuadër të javës së Mitingut të Poezisë në Gjakovë.

2.4 Shkëmbimi i përvojave dhe njohurive që kanë të bëjnë me menaxhimin e komunave respektive.

Neni 3
Të drejtat dhe detyrimet e palëve

Përfaqësuesit e Komunës së Gjakovës dhe të Komunës Lodëve e konfirmojnë vullnetin për krijimin e grupeve punuese ndërkomunale, për ofrimin e asistencës profesionale për hartimin e modeit të dokumenteve nga lëmi i kulturës, artit, arsimit, sporti etj, në bazë të të cilave do të bëhet përcaktimi për realizimin e projekteve konkrete të bashkëpunimit .

Neni 4
Korniza ligjore

4.1 Baza ligjore e Komunës së Gjakovës për lidhjen e kësaj Marrëveshje të Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar është neni 28 dhe 30 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale nr. 03/L-040, neni 18.2 i Ligjit për Bashkëpunim Ndërkomunal nr. 04/L-010, si dhe vendimi i Kuvendit të Komunës së Gjakovës 01 nr. 011-1208/2013 i dt. 28.02.2013.

4.2 Baza ligjore e Komunës Lodëve për lidhjen e kësaj Marrëveshje është -----

Neni 5
Burimet financiare

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje pajtohen që Bashkëpunimi Komunal Ndërkombëtar për realizimin e projekteve të cilat janë me interes të përbashkët, të mbështetet me mjetet e buxhetit të komunave respektive, si dhe me donacione dhe grante të individëve apo institucioneve përkatëse.

Neni 6
Dispozitat përfundimtare

Kjo Marrëveshje do të aplikohet në kohë të pacaktuar, e nëse krijohen kushte dhe situata të reja të cilat do të ndikojnë në qëndrueshmërinë e kësaj marrëveshjeje , e njëjta mund të plotësohet, ndryshohet, apo anulohet sipas propozimit të palëve dhe me pajtimin e tyre.

Neni 7

Palët nënshkruese të kësaj Marrëveshjeje e konfirmojnë vullnetin që mospajtimet të cilat janë të ndërlidhura me realizimin e ndonjë projekti, ti zgjidhin në frymën e marrëdhënieve të mira të bashkëpunimit komunal ndërkombëtar.

Neni 8

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar është përpiluar në 6 (gjashtë) kopje identike dhe pas nënshkrimit nga përfaqësuesit e autorizuar të palëve , secilës palë i dorëzohen nga 3 (tri) kopje .

Palët nënshkruese të Marrëveshjes për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar

Komuna e Gjakovës
Kryetari

Dr. Pal Lekaj

Komuna Lodëve
Kryetarja

Znj. Marie-Christine Bousquet